

Shtojca 1. Termat e Referencës

Ref. Nr. _____

Emri i kontratës: **Organizimi i punëtorive, prezantimeve dhe hartimi i modelit për përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë në jetën publike.**

1. Prapavija

Disa programe që trajtojnë çështjen e punësimit të komuniteteve jo-shumicë janë duke u zbatuar nga OJQ e tjera në Kosovë, por ato nuk e trajtojnë në mënyrë specifike çështjen në lidhje me angazhimin e këtyre komuniteteve në administratën lokale. Ky projekt i financuar nga UNMIK, ka për qëllim që në mënyrë specifike të trajtoj çështjet dhe barrierat e punësimit të komuniteteve pakicë në administratën lokale dhe të u ofroj komunave një model që mund të përdoret dhe përshtatet sipas nevojave me qëllim të rris pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në jetën publike.

Programi i LENS përmes projektit "Avokim për paraqitjen proporcionale të punësimit" do të çojë në krijimin e një strategjie të përfshirjes së komuniteteve pakicë, duke pas parasysh nevojat e këtyre komuniteteve dhe mungesës së kapaciteteve të komunave për të arritur gjendjen e dëshiruar të përfaqësimit proporcional të këtyre komuniteteve.

Programi do të rezultojë në një model për promovimin e procesit të aplikimit, udhëzime në plotësimin e formularëve të aplikimit, , transparencën gjatë procesit të rekrutimit dhe krijimin e strategjive për rritjen e mundësive për punësim proporcional.

Aktivitetet e këtij projekti do të trajtojnë çështjet e përfshirjes së kufizuar për vendet e punës në dispozicion, d.m.th. Si shpallen vendet e lira, si dhe udhëzimet për aplikimin për ato vende të lira dhe rritjen e transparencës në proces.

2. Objektiva

LENS po kërkon një kompani për të ofruar shërbime për organizimin e një punëtorie dhe një prezantimi për të identifikuar dhe modeluar çështjet dhe për të përmirësuar përfaqësimin proporcional të komuniteteve jo-shumicë në administratën lokale si dhe për të zgjeruar kapacitetet e autoriteteve lokale për të trajtuar çështjet në terren.

3. Fushëveprimi i shërbimit

Për shkak të fushës gjithëpërfshirëse dhe të gjerë të shërbimit, ne jemi duke kërkuar një kompani me përvojë për të realizuar këto detyra kryesore:

- Një punëtori dy-ditore për autoritetet e zgjedhura lokale dhe organet qendrore të autorizuar shtetërore;
- Një prezantim njëditor mbi rezultatet nga raporti hulumtues dhe prezantimi i strategjisë afatshkurtër;
- Facilitimi i sesioneve trajnuese nga së paku një trajner me përvojë profesionale në tema që lidhen me këtë thirrje;
- Ofrimi e shërbimeve teknike në lidhje për organizimin e punëtorive dhe prezantimit të rezultateve: hapësira, shërbime e përkthimit (shqip, serbisht dhe anglisht), ushqimi dhe pije freskuese për pjesëmarrësit;
- Raportim vlerësues i hollësishëm i moduleve me qëllim të përmirësimit të punëtorive sipas reagimeve të pjesëmarrësve;
- Zhvillimi i moduleve interaktive dhe të hollësishme të punëtorive / planit të trajnimit dhe të gjithë materialeve bazë për identifikimin e çështjeve që përballen me komunitetet jo shumicë për përfaqësim proporcional në administratën lokale dhe rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve lokalë për hartim të strategjive që do të adresonin çështjet e menjëhershme të hasura në terren dhe do të siguronin përgjigje të shpejta;
- Punëtoritë duhet të përfshijë, komponentët si në vijim: Angazhimi institucional për informimin e komuniteteve jo-shumicë për ushtrimin dhe njohjen e të drejtave dhe rëndësisë së tyre për pjesëmarrje në jetën publike, zgjerimin e marrëdhënieve të komunikimit, kanaleve e komunikimit, përfaqësimin e komuniteteve pakicë në administrata lokale, vende pune të disponueshme, d.m.th. si shpallen vendet e lira, si dhe udhëzime për aplikimin për ato vende të lira dhe rritjen e transparencës së këtij procesi;
- Sesionet duhet të parashikojnë t'i targetojn këto institucione: Në nivel komunal, drejtorët e Drejtorisë së Administratës, anëtarët e Komiteteve për Komunitete dhe Zyrat për Komunitetet Jo-shumicë. Në nivel qendror, Asociacionin e Komunave të Kosovës, Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Një raport prej punëtorive dhe prezantimeve mbi me rekomandimet dhe çështjet e identifikuar nga pjesëmarrësit në lidhje me përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë në jetën publike dhe për adresimin e mëtejshëm të nevojave të tyre përmes një strategjie afatshkurtër;
- Një strategji afat-shkurte dhe propozim modelet për adresimin e çështjeve bazuar në rezultatet e punëtorive dhe vizitave në terren;

4. Rezultatet e pritura

- Metodologjia përfundimtare për qasjen që do të përdoret gjatë trajnimeve;
- Pesë sesione të trajnimeve për 48 pjesëmarrës;
- Një seminar prezantimi me zyrtarët e bashkisë;
- Sigurimin e hapësirave, përkthimit dhe materialeve të domosdoshme për pjesëmarrësit e këtyre aktiviteteve;
- Facilitimin e punëtorive dhe sesioneve trajnuese;
- Vlerësimin dhe dorëzimin e raportit me çështjet e identifikuara;
- Dorëzoni rekomandimeve dhe dizajnimin e modeleve për ndërhyrje afat-shkurte në përmirësimin e situatës së prezantimit të komuniteteve jo-shumicë në administratën lokale.

Të gjitha shërbimet do të konsiderohen të përfunduara në kohën kur klienti deklaron i kënaqur me rezultatet.

5. Metodologjia

Kontraktuesi duhet të sigurojë një metodologji që do të përdoret për shërbimet, detajet për secilën fazë, së bashku me një plan paraprak për zbatimin e aktiviteteve.

6. Kohëzgjatja

- Pritet që nga 60 deri 75 ditë pune për të përfunduar të gjitha detyrat.

Vonesat në përmbushjen e kërkesave dhe / ose mungesa e cilësisë së shërbimeve, do të konsiderohen si arsye për ndërprerje.

7. Kualifikimet/Kriteret e përzgjedhjes

- Operatori duhet të jetë një person juridik i regjistruar në Kosovë;
- Operatori duhet të ketë kapacitete adekuate me përvojë të pasur nga fusha përkatëse;
- Kapacitete adekuate me trajner me përvojë në fushën përkatës dhe në ofrimin e shërbimeve të trajnimeve;
- Njohuri dhe eksperience e provuar, minimumi 3 vjet, në ofrimin e shërbimeve të ngjashme për organizatat e shoqërisë civile;
- Të paktën 3 vjet përvojë të dokumentuar për zhvillimin dhe artikullimin e dokumenteve, realizimin e seancave trajnuese interaktive;
- Aftësi të shkëlqyera në paraqitjen e informacionit komplekse në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme;

- Aftësi për të ofruar shërbime dhe produkte me cilësi të lartë në kohën e duhur;
- Të jetë në gjendje të ofrojë të gjitha dokumentet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.